



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:281483

Datë: 28.12.2020

Numri i dokumentit: 01374377

C.nr.1010/19

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Besnik Bislimaj, me zyrtaren ligjore Merita Xharavina, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses .J.R. nga Gjakova të cilën e përfaqëson i autorizuari .Y.B., avokat në Gjakovë, kundër te paditurës .K.GJ.- D.K.A., për shkak të kompensimit në emër të ushqimit në punë (shujtës), vlera e kontestit 2,324.00 euro, pas mbajtjes se seancës kryesore publike të datës 03.12.2020, më datë 28.12.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses .J.R.nga Gjakova, ashtu që: **DETYROHET** e paditura .K.GJ.- D.K.A. që në emër të kompensimit për ushqimin për praninë në punë për periudhën kohore 01.01.2015 e gjer më 29.02.2020, për ditët totale të pranisë në punë prej 1162 ditë dhe atë (për secilën ditë të pranisë në punë shumen nga 2 euro) paditëses .J.R.nga Gjakova, t'ia paguajë shumën totale prej 2,324.00.-€ (dymijë e treqind e njëzet e katër euro), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita nxjerrja e këtij aktgjykimi, me datë 28.12.2020, e deri në pagesën definitive si dhe **DETYROHET** e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditëses t'ia paguaje shumën totale prej 404.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor i çështjes është mbajtur në mungesë të të paditurës, në kuptim të nenit 423 par.4 të LPK-së.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja .J.R.nga Gjakova, përmes te autorizuarit të saj .Y.B., avokat në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, më datë 02.12.2019, ka ushtruar padi kundër të paditurës .K.GJ.- D.K.A., ku ka theksuar se paditësja është punësuar si mësimdhënëse e lëndës së Psikologjisë në Institucionin Arsimor "H.D" në Gjakovë. Paditëses nuk i është kompensuar ushqimi në punë për ditët e punës ashtu që duke pasur parasysh se e paditura ka obligim të paguajë nga 2 euro për çdo ditë pune, ka kërkuar kompensimin për ushqim në emër të ditëve të pranisë në punë, si dhe ka kërkuar kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës. Me datë 12.10.2020 i autorizuari i paditëses .Y.B., avokat në Gjakovë, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë sa i përket ditëve të pranisë në punë për paditësen, ku në emër të ushqimisë për 1162 ditë në punë ka kërkuar shumën prej 2,324.00 euro.

Në seancën për shqyrtim kryesor i autorizuari i paditëses .Y.B., avokat në Gjakovë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së precizuar me parashtrësën e datës 12.10.2020, i ka propozuar gjykatës që të bëjë administrimin e provave dhe kërkesëpadinë ta aprovojë si të bazuar. Gjersa në fjalën e tij përfundimtare, i njëjti ka deklaruar se në këtë çështje juridike me siguri janë vërtetuar të dhënat siç vijojnë : paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura para vitit 2015, se e paditura në bazë të kontratave kolektive ka pasur për obligim ti paguajë paditëses kompensimin për ushqimin gjatë punës për ditë të pranisë në punë. Vlera e kompensimit është 2 euro për çdo ditë të pranisë në punë. Në bazë të vërtetimit të Gjimmnazit “H.D”numër 216 të datës 12.10.2020 është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se paditësja ka pasur 1162 ditë të pranisë në punë, duke pasur parasysh se e paditura duhet t’i paguajë paditëses nga 2 euro për ditë të pranisë në punë për kompensim të shujtës, e paditura ka pasur për obligim paditëses t’i paguajë gjithsej 2,324.00 euro për periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri me datë 29.02.2020. Me provat e ekzaminuara kërkesëpadija është vërtetuar si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi. I ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, në emër të përfaqësimit në dy seanca nga 135 euro në shumë të përgjithshme prej 270.00 euro, si dhe në emër të taksës për padi shumë prej 30.00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 404.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi kaq theksuar se e kundërshtojë në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se .K.GJ.nuk është nënshkruese e kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për ti informuar dhe ndihmuar Komunitetin që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj.. dhe ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Vërtetimi i lëshuar nga Gjimmnazi “H.D”në Gjakovë me numër të protokollit 216 të datës 12.10.2020, Kontratat e punës me numër të protokollit 1558 e datës 01.09.2015.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është **e bazuar**.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga Gjimmnazi “H.D”në Gjakovë me numër të protokollit 216 të datës 12.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja .J.R .nga Gjakova në këtë institucion arsimor përkatësisht në Gjimmnazin “H.D”ka punuar gjithsej 1162 ditë.

Nga Kontratat e punës me numër të protokollit 1558 e datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja .J.R. nga Gjakova është e punësuar te e paditura .K.GJ.- Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, si mësimdhënëse e psikologjisë me orar të plotë prej 20 orë mësimi në javë apo 40 orë pune në javë dhe e cila ende vazhdon të punojë në të njëjtin vend të punës.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata nga administrimi i provave dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar se nuk është kontestues fakti që paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, përkatësisht punon si mësimdhënëse e lëndës së psikologjisë në Gjimnazin “H.D” në Gjakovë, në vitet shkollore 2014/2015, 2015/2016, 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 (vite këto për të cilat paditësja kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe atë nga data 01.01.2015 e gjer më 29.02.2020), ky fakt u vërtetua nga këto prova: Vërtetimi i lëshuar nga Gjimnazi “H.D” në Gjakovë me numër të protokollit 216 të datës 12.10.2020, Kontratat e punës me numër të protokollit 1558 e datës 01.09.2015.

Gjykata, nga provat në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura, gjegjësisht drejtori i Gjimnazit “H.D” në Gjakovë me numër 216 i lëshuar me datë 12.10.2020 ka vërtetuar se paditësja J.R. nga Gjakova te e paditura ka punuar gjithsej 1162 ditë në periudhën kohore 01.01.2015 e gjer më 29.02.2020, atëherë gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, për të cilat i është aprovuar shuma nga 2 euro për çdo ditë të pranisë në punë, shumë kjo e përcaktuar në Kontratën Kolektive të Arsimit.

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, iu referua nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017, në të cilën parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. E po ashtu, një gjë të tillë e ka paraparë edhe Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nr.36 e cila ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015, e cila në nenin 54 par.1 ka përcaktuar se *“të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete.”*. Prandaj, mbi këto baza, gjykata konstatoi se punëdhënësi i paditëses është pikërisht e paditura me çka vërtetohet edhe nga kontratat e punës që gjenden në shkresat e lëndës, andaj raporti juridik i paditëses me të paditurën të njëjtën e bën legjitime dhe me detyrim për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, po ashtu me rastin e vendosjes pati parasysh edhe nenin 90, par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, në të cilën parashihet *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, ndërsa në nenin e përcaktuara të lartë cituara është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret të paditurës për kompensimin e ushqimit në punë edhe pse të njëjtë nuk janë nënshkruar të Kontratës Kolektive të Arsimit, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësit.

Gjykata, me rastin e vendosjes pati parasysh edhe kundërshtimet e përfaqësuesit ligjor të të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, në lidhje me atë se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të datës 18.04.2017, si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve të kërkuara, mirëpo gjykata këto pretendime i refuzoi si të pa bazuar për arsye se paditësit nuk janë përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga kontrata e lartcekur. Përveç kësaj dispozita e nenit 46 të kësaj kontrata ka karakter udhëzues e jo imperativ apo detyrës dhe se nuk është bazë juridike për refuzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata analizoi edhe pretendimet dhe deklaratimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk i morri për bazë pasi që të njëjtat nuk kanë ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 paragrafi 1 te LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, në emër të përfaqësimit në dy seanca nga 135 euro në shumë të përgjithshme prej 270.00 euro, si dhe në emër të taksës për padi shumë prej 30.00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 404.00 euro.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1010/19, datë 28.12.2020

Zyrtare ligjore
Merita Xharavina

GJYQTARI,
Besnik Bislimaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.